

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kritikohet për dështim të plotë spitali në Angli ku u vranë 7 foshnja nga infermierja
ADRESA	https://www.koha.net/bote/kritikohet-per-deshtim-te-plote-spitali-ne-angli-ku-u-vrane-7-foshnja-nga-infermierja
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 01:58:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 14:51:22 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3d1145c2194e962d568d3c5518850ca771b745775f82d9e88c89effb01d5a53d
TEKSTI	51ac5ce721812aea6edb54bd3b4c47a4282a79394e1bb8c84580a5534d9df60d
PAMJA	59a6928ddf682549b23441e798e8240fc515412786e3d78de3431eb222b0dac0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2e3a15ce95d65595b060841e815716440efee5b2a2a8980bdf53125326d63a4d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b76c045c30cbbea9eae7a42cd456659a809b623ad6b8382f688578771e275bcf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2e3a15ce95d65595b060841e815716440efee5b2a2a8980bdf53125326d63a4d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

BOTË

Kritikohet për dështim të plotë spitali në Angli ku u vranë 7 foshnja nga infermierja




Foto: Associated Press

15 shtator 2026 16:51

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Një gjyqtare angleze ka publikuar të martën një raport të ashpër, duke fajësuar menaxhimin jofunksional dhe një "dështim të plotë në të gjitha nivelet" për mbrojtjen e foshnjave në spitalin ku infermierja neonatale, Lucy Letby, u shpall fajtoare për vrasjen e shtatë të porsalindurve.

Hetimi për vdekjen e foshnjave konstatoi se spitali Countess of Chester, në veriperëndim të Anglisë, mund të kishte shpëtuar disa prej tyre nëse stafi do të kishte vepruar më herët, kur fëmijët filluan të përkeqësoheshin, ka thënë gjyqtarja Kathryn Thirlwall.

"Gabime u bënë nga infermierët, mjekët dhe drejtuesit", ka thënë Thirlwall. "Kishte gjithashtu një dështim të plotë në të gjitha nivelet për të aktivizuar në çdo moment procedurat e mbrojtjes së fëmijëve", ka shtuar ajo.

Letby, 36 vjeçe, po vuan dënim me burgim të përjetshëm për vrasjen e shtatë foshnjave dhe tentativën për të vranë shtatë të tjera. Ajo ka këmbëngulur se është e pafajshme, ndërsa një ekip mbrojtës i mbështetur nga dhjetëra shkencëtarë, të cilët kanë vënë në pikëpyetje provat kundër saj, po përpiqet të pastrojë emrin e saj.

Hetimi i drejtuar nga Thirlwall nuk shqyrtoi dënimet e Letbyt, por u përqendrua te mënyra se si dështimet institucionale i ekspozuan foshnjat ndaj rrezikut në spital, si dhe te mënyra se si stafi dhe drejtuesit reagues dhe trajtuan prindërit.

Edhe



Botë • 23 kor 2026

Gërmimet në shtëpinë e fëmijëve në Irlandë zbulojnë mbetjet e 99 foshnjave

Ajo u përqendrua te dështimi i stafit për të ndërhyrë, kur u bë e qartë se dikush po u shkaktonte qëllimisht dëm foshnjave.

"Sa jetë mund të ishin shpëtuar nëse spitali do të kishte vepruar më herët?", ka thënë ajo. "Edhe në qartësi se disa foshnja do të ishin

Futboll.

Espi e shpëton Realin nga turpi

Arbëri.

Kurti: Shqiptarët e Luginës kanë nevojë për bashkëpunim e përgjegjësi të përbashkët

Arbëri.

Hehir: Turp i madh që një gjykatë e huaj që iu imponua Kosovës t'i shpallë fajtorë figurat e UÇK-së

Futboll.

Zyrtare: Lionel Messi ftohet nga Argjentina

Kulturë.

"Lufta nën akuzë..." demaskon rishkrimin e historisë së çlirimit

Futboll.

Liverpooli eliminon Tottenhamin nga Kupa e Ligës

maternitet, ka thënë ajo. Është e qartë se disa foshnjat do të kishin shpëtuar dhe disa sulme do të ishin parandaluar nëse do të ishte ndërmarrë veprim më herët", ka shtuar

Letby është shpallur fajtores në vitin 2023 për vrasjen e shtatë foshnjave dhe tentativën për të vrarë gjashtë të tjera, përfshirë dy tentativa ndaj të njëjtit fëmijë. Në një rast ku juria nuk arriti të merrte një vendim, çështja u rigjykua dhe Letby u shpall fajtores për një tjetër tentativë vrasjeje.

Prokurorët thanë se ajo i dëmtonte foshnjat në mënyra që linin pak gjurmë, përfshirë injektimin e ajrit në qarkullimin e tyre të gjakut, futjen e ajrit ose qumështit në stomak përmes tubave nazogastrikë, helmimin me insulinë dhe ndërhyrjen në tubat e frymëmarrjes.

Ajo ishte e vetmja punonjëse në detyrë në njësinë neonatale kur fëmijët u përkeqësuan ose vdiqën, midis qershorit 2015 dhe qershorit 2016. Prokurorët e përshkruan atë si një "prani të vazhdueshme keqdashëse".

Raporti i Thirlwall përshkruan se si një numër i madh fëmijësh u dëmtuan, por shqetësimet ose nuk u ngritën fare, ose dyshimet nuk iu përcollën drejtuesve.

"Kjo nuk ndodhi", ka thënë Thirlwall. "Përkeqësimet dhe vdekjet vazhduan", ka shtuar ajo.

Edhe



Botë • 4 qer 2026

"Dërgoni në shtëpi" – Skandali i maternitetit në Nottingham që shkaktoi vdekje të shumë foshnjave

Edhe pasi spitali filloi të shqyrtonte rritjen e numrit të vdekjeve të foshnjave dhe lidhjet me turnet e punës së Letbyt, si dhe pasi infermierja u transferua në detyra administrative në korrik 2016, policia nuk u thirr deri në maj 2017. Letby qëndroi në spital deri në arrestimin e saj më shumë se një vit më vonë.

Avokatët e Letbyt u përpoqën pa sukses ta ndalonin hetimin, duke argumentuar se ai mund të arrinte në përfundime të gabuara.

#ANGLI

#SPITALI

#FOSHNJIA

#VRASJA

Artikuj të ngjashëm



Botë • 6 mar 2026

Gratë e prangosura gjatë lindjes: "U trondita shumë kur nuk m'i hoqën prangat"



Botë • 14 jan 2026

Vdesin nëntë foshnje të sapolindura në Siberi, Rusia ndalon mjekun kryesor të spitalit



Botë • 26 nën 2025

Dënohet me burgim të përjetshëm gruaja nga Zelanda e Re që vrau dy fëmijët e saj

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzimet për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.